

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RREGULLORE PËR MËNYRËN E VEPRIMIT TË POLICISË GJATË KOHËS SË ZBATIMIT TË ZGJEDHJEVE

Shkup, shkurt 2014

Në bazë të nenit 31 paragrafi(2) alineja 1, në lidhje me nenin 33 paragrafi(1) dhe (4) dhe neni 35 paragrafi(1) dhe (2) të Kodit zgjedhor (Gazeta zyrtare e RM", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08,44/11,51/11,142/12.34/2013 dhe 14/2014) Komisioni shtetëror i zgjedhjeve në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme,ne seancën e mbajtur më _____2014, miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN E VEPRIMIT TË POLICISË GJATË KOHËS SË ZBATIMIT TË ZGJEDHJEVE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e veprimit të policisë,si dhe aktivitetet e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, të Komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të këshilleve zgjedhorë gjatë kohës së zbatimit të zgjedhjeve.

II. AKTIVITETET E KOMISIONIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Neni 2

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, më së voni 48 orë para ditës së caktuar për dorëzimin e materialit zgjedhor komisioneve komunale të zgjedhjeve me kërkesë e njofton Ministrinë e punëve të brendshme për sigurimin e dorëzimit të materialit prej KSHZ-së deri në komisionet komunale përkatëse të zgjedhjeve.

Në kërkesë ceket:

- dita dhe koha e fillimit të dorëzimit të materialit zgjedhor;
- adresa/vendi prej ku do të fillojë të lëvizë konvoji me material zgjedhor dhe adresat dhe objektet ku gjenden selitë e komisioneve komunale përkatëse të zgjedhjeve ;
- destinacioni i fundit (Komisioni komunal i zgjedhjeve i fundit)ku do të dorëzohet materiali zgjedhor;
- itinerari i vendeve në të cilat do të kryhet dorëzimi.

Në përjashtim, personi përgjegjës i Ministrisë së punëve të brendshme në pajtim me anëtarin e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, mund ta ndryshojnë itinerarin vendeve ku do të bëhet dorëzimi.

III. AKTIVITETET E KOMISIONITKOMUNAL TË ZGJEDHJEVE

Neni 3

Komisionet komunale të zgjedhjeve më së voni 23 orë para ditës së caktuar për dorëzimin e materialit zgjedhor këshilleve zgjedhorë, me kërkesë e njofton Ministrinë e punëve të brendshme për sigurimin e dorëzimit të materialit prej KKZ-së deri në Këshillet përkatës zgjedhorë.

Në kërkesë ceket:

- dita dhe koha e fillimit të dorëzimit të materialit zgjedhor,
- adresa/vendi prej ku do të fillojë të lëvizë konvoji me material zgjedhor dhe adresat dhe objektet ku gjenden selitë e këshilleve zgjedhorë;
- destinacioni i fundit ku do të dorëzohet materiali zgjedhor;
- itinerari i objekteve/vendeve në të cilat do të kryhet dorëzimi.

Në përjashtim, personi përgjegjës i Ministrisë së Punëve të Brendshme në pajtim me anëtarin e Komisionit komunal të zgjedhjeve mund ta ndryshojnë itinerarin vendeve ku do të bëhet dorëzim

IV. AKTIVITETET E KËSHILLIT ZGJEDHOR GJATË KOHËS SË ZGJEDHJEVE

Neni 4

Këshilli zgjedhor kujdeset për mirëmbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotim.

Këshilli zgjedhor për rivënjen e rendit në vendvotim mund të kërkojë ndihmë nga policia

Këshilli zgjedhor mund ta thërras policinë në vendvotim nëse për këtë ka nevojë

Kryetari ose zëvendës kryetari i Këshillit zgjedhor mund ta thërras policinë përshkak të largimit të personave jo të autorizuar në objektin dhe lokalitë e për votim.

Në përjashtim, nëse përshkak pengimit ose mungesës kryetari ose zëvendës kryetari nuk kanë mundësi të veprojnë në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, policinë mund ta thërras anëtarin e këshillit zgjedhor dhe për këtë e njofton Komisionin komunal të zgjedhjeve

Thirrja e policisë sipas paragrafit 3, 4 dhe 5 të këtij neni bëhet me gojë, me shkresë, me anë të telefonit, me faks ose në mënyrë tjetër të duhur.

Nevoja për thirrjen e policisë konfirmohet në Formularin 1, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

V. MËNYRA E VEPRIMIT TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDËSHME GJATË DORËZIMIT TË MATERIALIT ZGJEDHOR DHE GJATË ZBATIMIT TË ZGJEDHJEVE

Neni 5

Ministria e Punëve të Brendshme, pas pranimit të kërkesës të nenit 2 të kësaj Rregulloreje prej Komisionit shtetëror të zgjedhjeve dhe Komisionit komunal të zgjedhjeve, përgaditë plane për sigurimin e personave dhe të materialit zgjedhor.

Ministria e Punëve të Brendshme, numrin e personave zyrtarë të autorizuar dhe mënyrën e sigurimit e përcakton në pajtim me vlerësimin e kryer të sigurimit..

Konvoi është i siguruar gjatë tërë kohës së dorëzimit të materialit zgjedhor.

Neni 6

Policia siguron objektin në të cilin gjendet vendvotimi dhe ardhjen në vendvotim. Policia nuk lejon qëndrimin e personave të paautorizuar para objektit ku gjendet vendvotimi.

Policia vetëm me kërkesë të këshillit zgjedhor rivendos rendin dhe qetësinë në vendvotim.

Policia, me kërkesë të organit të autorizuar zgjedhor, është e detyruar që personat e paautorizuar të cilët prishin rendim dhe qetësinë, ti largojë nga vendvotimi, vetëm në rast se është e pamundëshme rivendosja e rendit

Policia, me kërkesë të organit të autorizuar zgjedhor, është e detyruar që kryetarin, zëvendës kryetari ose anëtarin e këshillit zgjedhor të cilët e prishin rendin dhe qetësinë, ti largojë nga vendvotimi, vetëm në rast se është e pamundëshme rivendosja e rendit

Neni 7

Policia, gjatë kohës së zbatimit të votimit, vendvotimet ku mbahet votimi i siguron në bazë të planit të më parë konfirmuar për sigurim. Policia, sigurimin e kryen në uniformë standarde, publikisht, transparente, funksionale në mënyrë që qytetarëve do t'ju sigurojë siguri..

Policia, në përputhshmëri me vlerësimin e kryer të sigurimit, i siguron objektet në të cilët janë të vendosura gjitha 3480 vendvotimet

Policia me kërkesë të tyre i siguron Kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve.

Policia, i siguron komisionet komunale të zgjedhjeve në përjashtim për shkaqe sigurie.

Neni 8

Policia, vendvotimin e siguron duke filluar prej orës 6.00 pandërprerë deri më ora 19.00, përkatësisht deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Policia, pas mbylljes së vendvotimit, gjatë kohës së sumimit të rezultateve objektin dhe lokalit ku është i vendosur vendi i votimit dhe këshilli zgjedhor i siguron dhe i largon personat e paautorizuar nga objekti.

Policia e siguron këshillin zgjedhor, në se kërkohet nga ana e tyre deri në dorëzimin e procesverbalit dhe materialin zgjedhor në Komisionin komunal të zgjedhjeve.

Член 9

Policia, pas mbylljes së vendvotimit, i largon gjithë personat e paautorizuar prej objektit.

personat të autorizuar llogariten:

- anëtarët e këshillit zgjedhor;
- anëtarët e Komisionin komunal të zgjedhjeve.
- anëtarët e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve;
- përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave;
- vëzhgues të akredituar të vendit dhe ndërkombëtarë ;
- gazetarë të akredituar të vendit dhe ndërkombëtarë dhe mediat .

Neni 10

Kjo Rregullore me ditën e miratimit hyn në fuqi..

Me hyrje në fuqi të kësaj rregullore, pushon vlefshmëria e Rregullores numër 10- 125/3 të 25.05. 2006

numër _____

KRYETAR

Shkup

I KOMISIONIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE,

NIKOLLA RILLKOSKI

Formulari 1

Formulari në lidhje me nevojën e thirrjes së policisë nga Këshilli zgjedhor dhe veprimi i policisë në Vendvotim _____ në ditën e votimit _____ 2014

Këshilli zgjedhor në vendvotimin _____ e Komisionit komunal të zgjedhjeve _____ kompetente për komunat _____ më _____ 2014, në ora _____, verifikoi dhe thirri policinë për vendosjen e rendit në vendvotim përshkak se:

(ceken shkaqet e nevojës së thirrjes së policisë).

Këshilli zgjedhor menjëherë pas vendosjes së rendit në vendvotim në ora _____, e plotëson dhe e nëshkruan formularin, kështu që një ekzemplar i mbetet këshillit zgjedhor, ndërsa një ekzemplar i dorëzohet personit të autorizuar të policisë.

PRANOI
Ministria e punëve të brendëshme

KRYETAR
i Këshillit zgjedhor

(emri dhe mbiemri)

ZËVENDËS-KRYETAR
i Këshillit zgjedhor

Personi i autorizuar zyrtar,

(emri dhe mbiemri)

Anëtarë të Këshillit zgjedhor:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____